



ZGJEDHJET LOKALE NË KOSOVË DO TË MBAHEN MË 12 TETOR

FAQE 3



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka caktuar 12 tetorin datë për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta lokale. "Ky vendim është marrë pas shqyrtimit të kujdesshëm të propozimeve të subjekteve politike si dhe pas një

analize të plotë, në përputhje me afatet kushtetuese dhe ligjore", u tha në njoftimin e Presidencës së Kosovës. Caktimi i kësaj date, sipas Presidencës, synon të mundësojë përgatitje të plotë të procesit zgjedhor nga

institucionet përgjegjëse, përfshirë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe institucionet e tjera relevante, "me qëllim të respektimit të standardeve më të larta të administrimit zgjedhor"

**KOSOVA
VAZHDON
TË JETË PA
KUVEND
FUNKSIONAL**

F. 3



**PSE PO
KËRKOHEM
RIKTHIMI I
MINISTRISË SË
MIRËQENIES
SOCIALE?**

F. 4-5



**SHEFI I NATO-s BËN THIRRJE
PËR FORCIM 400 PËR QIND TË
MBROJTJES AJRORE**

F. 2

**NË BE JANË TË SHQETËSUAR PËR
SIGURINË, NË BALLKAN PRIORITET
MBIJETESA**

F. 8

KOSOVA NË EXPO OSAKA 2025

F. 7

EKONOMI



**HAPET PANAIRI NDËRKOMBËTAR
"PRISHTINA 2025", OEK-u FTON
BIZNESET PËR PJESËMARRJE**

F. 8

**RIZVANOLLI VIZITOI SHKOLLAT
"ISA BOLETINI" DHE "HAMIT
SEJDIU", SHEH INVESTIMET NË
EFICIENCË TË ENERGJISË**

F. 8

SPORT



**SHTATË VJET PA LEGJENDËN
FADIL VOKRRI**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shefi i NATO-s bën thirrje për forcim 400 për qind të mbrojtjes ajrore

BRUKSEL, 9 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, bëri thirrje më 9 qershor për një rritje prej 400-përqindësh të mbrojtjes kundërajrore dhe raketore, për ta mbrojtur aleancën veriatlantike nga kërcënimet e Rusisë. “Në Ukrainë po shohim se si Rusia përdor terrorin nga ajri, prandaj do ta forcojmë mburojnë që mbron qiellin tonë”, tha Rutte gjatë një fjalimi në institutin Chatham House në Londër, sipas deklaratës së publikuar nga AFP. “NATO-s i duhet një rritje prej 400-përqindësh e kapaciteteve të mbrojtjes ajrore dhe raketore për ta ruajtur një parandalim dhe mbrojtje të besueshme”, shtoi ai. “Fakt është që kemi nevojë për një rritje të madhe në mbrojtjen tonë kolektive”, theksoi ai. Rutte do të takohet me kryeministrin e Britanisë së

Madhe, Keir Starmer, të hënën, për herë të dytë në Downing Street që nga ardhja në pushtet e liderit laburist në korrik 2024. Komentet e Ruttes vijnë para Samitit të NATO-s që do të mbahet këtë muaj në Holandë. Por, Moska i ka dënuar menjëherë deklaratat e tij, duke e cilësuar NATO-n si një “instrument agresioni”. “NATO po shfaqet si një instrument agresioni dhe përballjeje”, deklaroi zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, para gazetarëve në Moskë. Presidenti amerikan Donald Trump po ushtron presion ndaj vendeve anëtare të NATO-s t'i rrisin ndjeshëm buxhetet e tyre ushtarake. Ai po kërkon që shpenzimet për mbrojtje të arrijnë në pesë për qind të bruto produktit të brendshëm (BPB) nga caku i tanishëm prej dypërqindësh. Sekretari amerikan i Mbrojtjes,



Pete Hegseth, deklaroi javën e kaluar në Bruksel se aleatët janë afër arritjes së një marrëveshjeje për cakun e ri prej pesëpërqindësh, i cili pritet të formalizohet në Samitin e Hagës. “Besojmë se brenda pak javësh kjo aleancë do të zotohet për pesë për qind, nga të cilat 3.5 për qind do të shkojnë për armatim të rëndë dhe 1.5 për

qind për infrastrukturë dhe aktivitete mbrojtëse”, tha Hegseth të enjten. “Ky është zotim real dhe besojmë se çdo vend mund ta rrisë kontributin e vet”. Vendet anëtare të NATO-s janë duke punuar për t'i rritur kapacitetet mbrojtëse që prej fillimit të luftës së Rusisë kundër Ukrainës në shkurt 2022.

“Reziku nuk do të zhduket as kur të përfundojë lufta në Ukrainë”, theksoi Rutte më 9 qershor. “Na duhen më shumë trupa dhe kapacitete për t'i zbatuar plotësisht planet tona mbrojtëse. Ushtritë tona kanë nevojë për mijëra automjete të blinduara dhe tanke, si dhe miliona predha artilerie”, theksoi ai. Britania javën e kaluar njoftoi plane për ndërtimin e deri 12 nëndetëseve bërthamore dhe gjashtë fabrikave për prodhimin e municionit dhe predhave, si përgjigje ndaj asaj që e cilëson si kërcënim nga Rusia. Më herët këtë vit, qeveria e Starmerit premtoi t'i rrisë shpenzimet për mbrojtje në 2.5 për qind të BPB-së deri në vitin 2027, por ende nuk ka përcaktuar një afat të qartë për rritje të mëtejshme. “NATO duhet të bëhet një aleancë më e fortë, më e drejtë dhe më vdekjeprurëse”, përfundoi Rutte.

Zelensky thotë se po bën trysni për këmbimin e të burgosurve, por e akuzon Putinin për “lojëra të ndyra”

KIEV, 9 QERSHOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë se do t'i vazhdojë përpjekjet për këmbimin e të burgosurve me Moskën, megjithëse shprehur dyshime se do të ketë sukses. “Ukraina vazhdon të bëjë gjithçka që është e mundur për ta siguruar lirinë e robërve tanë të luftës dhe kthimin e trupave të luftëtarëve tanë të rënë”, tha Zelensky në adresimin e tij të përnatshëm me video. “Fatkeqësisht, listat e plota nga Rusia për këmbimin e mbi 1 000 njerëzve, siç ishte rënë dakord në Stamboll, ende nuk janë dorëzuar. Si zakonisht, pala ruse po përpjeket sërish t'i shndërrojë edhe çështjet e tilla në lojë të ndyrë politike dhe informacioni”, shtoi ai. Nëse Kremlini “nuk u përmbahet marrëveshjeve, madje as për çështje humanitare, kjo do t'i



vërë në pikëpyetje të madhe të gjitha përpjekjet ndërkombëtare - veçanërisht ato të Shteteve të Bashkuara - për bisedime dhe diplomaci”. Ndërkohë, Zelensky i tha rrjetit televiziv amerikan ABC se vetëm “trysnia e madhe” nga Uashingtoni dhe Evropa mund

ta detyrojë presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, të lëshojë pe. “Pastaj, ata do ta ndalin luftën”, tha ai. Të dielën zyrtarët ukrainas hodhën poshtë akuzat e Rusisë se Kievi po e zvarriste këmbimin e të burgosurve të luftës dhe kthimin e trupave të ushtarëve të rënë.

Këshilltari i Kremlinit, Vladimir Medinsky, pretendoi se Ukraina kishte shtyrë papritur si shkëmbimin e të burgosurve, po ashtu edhe pranimin e trupave të ushtarëve për kohë të pacaktuar. Medinsky tha se Rusia tashmë i kishte dorëzuar Ukrainës një listë me 640 të burgosur - duke u dhënë përparësi të plagosurve, të sëmurëve rëndë dhe të rinjve - për ta nisur procesin e shkëmbimit. Shtabi Koordinues i Ukrainës për Trajtimin e Robërve të Luftës deklaroi se pretendimet e Rusisë nuk përputhen me realitetin apo marrëveshjet e mëparshme. Sipas zyrtarëve ukrainas, megjithëse të dyja palët ishin pajtuar në parim për kthimin e trupave të rreth 12 000 ushtarëve të vdekur pas bisedimeve për paqe në Stamboll, nuk ishte caktuar asnjë datë specifike për

këmbimin. Ministria e Mbrojtjes e Ukrainës akuzoi Moskën se po bën përpjekje për t'i “rishkuar” marrëveshjet e arritura në Stamboll dhe për krijimin e “pengesave artificiale dhe deklaratave të rreme” për ta shtyrë procesin. Ministria paralajmëroi se nëse Rusia nuk i përmbush premtimet e veta, e vë në pikëpyetje besueshmërinë e ekipit negociator rus. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, u ka kërkuar të dyja palëve ta përfundojnë luftën e cila nisi në shkurt 2022. Kievi është pajtuar me thirrjen e ShBA-së për një armëpushim 30-ditor. Moska ka kundërshtuar dhe ka thënë se së pari duhet të përmbushen disa kushte të cilat janë të papranueshme për Ukrainën.

Arrestohet lideri i partisë kryesore opozitare në Republikën Sërpska

SARAJEVE, 9 QERSHOR - Millan Milliqeviq, kryetar i Partisë Demokratike Serbe, u arrestua të hënën, konfirmuar nga kjo parti, që është më e madhja opozitare në Republikën Sërpska të Bosnjë-Hercegovinës. Ministria e Punëve të Brendshme e këtij entiteti njoftoi se oficerët e Drejtorisë së Policisë Kriminale të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Sërpska, nën mbikëqyrjen e Departamentit Special për

Luftimin e Korrupsionit dhe disa departamenteve të tjera, kryen një aksion operativ të koduar “Blloku”. Në njoftimin e MPB-së thuhet se personat me inicialet M. M., M. D. dhe M. J. - të gjithë nga qyteti Teslliq - u privuan nga liria, nën dyshimet se kanë kryer vepra penale të ndikimit dhe pranimit të ryshfetit. Në njoftim thuhet, gjithashtu, se oficerët e policisë kanë sekuestruar rreth 45 000 euro gjatë hetimeve në gjashtë muajt e fundit, me urdhër të

gjykatës kompetente. Këto para thuhet se buronin nga veprimet korruptive të personave të përmendur dhe se ato janë depozituar në depozitën e gjykatës. Personat e privuar nga liria do t'i dorëzohen prokurorit kompetent të Prokurorisë së Republikës Sërpska brenda afatit ligjor, njoftoi Ministria e Punëve të Brendshme e këtij entiteti. Nga Partia Demokratike Serbe në Teslliq thanë se “kjo është një përpjekje e dukshme për



frikësim politik, duke krijuar vullnetit të shprehur të kaos dhe dhunë kundër qytetarëve”.

KOSOVA VAZHDON TË JETË PA KUVEND FUNKSIONAL

As pas tentimit të 29 deputetët nuk kanë arritur ta konstitujnë Kuvendin e Kosovës. Sikurse edhe në vazhdimet e kaluara të seancës konstituive, e cila ka nisur më 15 prill, skenari ishte i njëjtë: seanca zgjati pak minuta, dhe vazhdon pas 48 orësh. Seanca e radhës do të mbahet më 11 qershor

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar edhe të hënën ta konstitujnë përbërjen e re parlamentare. Ata janë mbledhur 29 herë deri tani në përpjekje për ta bërë Kuvendin pas zgjedhjeve të 9 shkurtit.

Sikurse edhe në vazhdimet e kaluara të seancës konstituive, e cila ka nisur më 15 prill, skenari ishte i njëjtë: seanca zgjati pak minuta, dhe vazhdon pas 48 orësh. Seanca e radhës do të mbahet më 11 qershor.

Çështja ka ngecur tek emërimi i kryetarit dhe i nënkryetarëve të Kuvendit.

Kjo është hera e 21-të që Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe nuk propozojnë nga një anëtar për formim të komisionit për votim të fshehtë për kandidaten e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, për kryetare të Kuvendit, meqë Haxhiu nuk ka arritur t'i marrë 61 votat e domosdoshme në votim të hapur.

Lëvizjes Vetëvendosje (LV), si fituese të zgjedhjeve, i takon ta propozojë kandidatin për kryetar Kuvendi, por ajo këmbëngul vazhdimisht që Haxhiu është figura e duhur, ndonëse për partitë e tjera ajo është e papranueshme dhe përçarëse. Çështja e ndërrimit të mënyrës së votimit - nga të hapur në të fshehtë - është dërguar për interpretim në Gjykatën Kushtetuese nga parti që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. Sipas tyre, propozimet e LV-së nuk janë kushtetuese dhe kanë kërkuar nga Gjykata të vendosë “një masë të

përkohshme për ndalimin e mbajtjes së seancave, derisa me prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe të marrë një vendim”.

Deputetët duhet ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët për ta konstituuar përfundimisht Kuvendin e ri.

Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re.

Përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje kanë përmendur së fundmi mundësinë që zgjedhjet e reja të parakohshme parlamentare të mbahen njëkohësisht me ato lokale të rregullta, të cilat pritet të shpallen në muajin tetor, si mundësi për zhblokim të situatës.

Albulena Haxhiu e Lëvizjes Vetëvendosje e paraqiti e para këtë ide në një takim që ka zhvilluar Osmani javën e kaluar me figura të subjekteve politike në Kosovë për të diskutuar datën e zgjedhjeve lokale. Megjithatë, Abelard Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës tha javën e kaluar se beson që zgjedhjet duhet të mbahen ndaras.

Haxhiu: Propozimi për qeveri të unitetit, tendencë për ta zvogëluar vullnetin e popullit

E propozuara e Lëvizjes Vetëvendosje për kryeparlamentare, Albulena Haxhiu, ka thënë se propozimi për qeveri të unitetit është tendencë për ta zvogëluar vullnetin e popullit. Sipas saj, përgjegjësia për konstituim të Kuvendit nuk i takon vetëm LV-së, por edhe partive të tjera politike. Kështu u shpreh ajo pas dështimit të herë të 29 për konstituim të legjislaturës së nëntë të Kuvendit të Kosovës.



Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje tha se “kërkojnë unitet për konstituim të Kuvendit”. “Ne kërkojmë unitet për konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Pra, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të kemi unitet që ta konstitujmë Kuvendin e Kosovës. Qytetarët e Republikës së Kosovës e kanë thënë fjalën e tyre në zgjedhjet e 9 shkurtit. Kryeministri Kurti është lideri më i votuar ndonjëherë në Republikën e Kosovës dhe LV-ja sot është subjekti i parë me më së shumti vota në vend. Prandaj, propozime të tilla janë tendencë për ta zvogëluar vullnetin e popullit, për ta shkelur atë dhe natyrisht nuk e kanë mbështetjen e LV-së. Ata thonë qeveri e tranzicionit, e të tjera, por qeveri të tranzicionit e kemi për momentin, sepse qeveria jonë, qeveria në dorëheqje apo në detyrë, është edhe qeveri e tranzicionit, sepse e kryejmë detyrën deri në qeverinë e ardhshme. Prandaj, le t'i braktisin këto qëndrime të cilat janë kundër vullnetit të popullit”, ka thënë Haxhiu.

Çitaku: Lëvizja Vetëvendosje të reflektojë

Deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se sot bëhen katër muaj nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në Kosovë. Sipas saj, katër muaj prej kur qytetarët e vendit, me pjesëmarrje të madhe dhe vullnet të qartë, votuan për përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Republikës. “Për fat të keq, katër muaj më vonë Kosova vazhdon të jetë pa parlament funksional dhe,

rrjedhimisht, pa institucione që do të duhej t'i adresonin sfidat reale dhe të përditshme të qytetarëve tanë. Tashmë në 29 seanca të thirrura inati ka zëvendësuar arsyen për shkak të barrikadimit kokëfortë të Lëvizjes Vetëvendosje, e cila, në mungesë të shumicës, po përpiqet ta imponojë vullnetin si normë. Diktati nuk është dhe nuk mund të jetë instrument i ligjshëm i qeverisjes demokratike. Kjo mënyrë e të menduarit dhe të vepruarit duhet të marrë fund. Edhe njëherë i bëjmë thirrje Lëvizjes Vetëvendosje që të reflektojë. E drejta për të zgjedhur dhe për të pasur institucione funksionale nuk është privilegj i dhuruar, por e drejtë e fituar me mund, djersë dhe sakrificë”, ka thënë Çitaku pas përfundimit të seancës.

Abdixhiku: Uniteti sot nuk është luks, është domosdoshmëri

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka përsëritur thirrjen drejt liderëve të LV-së, të PDK-së, të AAK-së dhe të Nismës që t'i kthehen propozimit të tij për një qeveri të unitetit. “Ta vlerësojnë me kujdes. Vazhdoj të besoj se mund të ulemi, të flasim dhe të pajtohemi për një zgjidhje të përbashkët. Kjo krizë mund të na shërbejë si mundësi nëse e trajtojmë me guxim dhe me përgjegjësi. Natyrisht se ka zëra mjaft që na ushqejnë që të rrimë larg, por sot para vetes kjo krizë na thërret veç për përgjegjësi. Asgjë më pak. Prandaj, gjatë kësaj jave

do të shkoj edhe një hap tutje. Pas finalizimit të konsultimeve të brendshme, do të dal me një agjendë 15 pikëshe - një platformë konkrete bashkëpunimi për qeverinë e unitetit, të cilën do t'ua ofroj të gjitha partive politike. Shpresoj që të kuptohet qartë: uniteti sot nuk është luks, është domosdoshmëri. Po, Kosovës i duhet një opozitë. Po, Kosovës i duhet një balanc demokratik. E para të dyjave, Kosovës i duhet një pozitë. Një qeveri legjitime, një Kuvend funksional, një shtet që punon - tek më pas një opozitë që kritikon”, ka thënë Abdixhiku.

Berisha: Nëse Zoti nuk dërgon një pejgamber, atëherë gjakderdhja është e pashmangshme

Pas dështimit për të disatën herë të Kuvendit të Kosovës, deputeti i AAK-së, Bekë Berisha, ka drejtuar kritika ndaj partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje. Berisha në rrjetin social “Facebook” ka shkruar se “nëse Zoti nuk dërgon një pejgamber, atëherë gjakderdhja është e pashmangshme”.

“29 herë dështim! 1. Kur nuk mundesh për të komunikuar as me u marrë vesh me askënd! 2. Kur nuk respektohet asnjë vlerë. 3. Kur i vjetri për të riun është barrë edhe i panevojshëm. 4. Kur materializmi mbizotëron mbi gjithçka. 5. Kur çdo budallë shprehet lirshëm dhe ka ndikim në shoqëri. 6. Kur rrena e mashtrimi mbizotërojnë dhe marrja s'ka kuptim. 7. Ku njerëzit bëjnë homazhe para heronjve për çdo ditë teknikisht dhe përloshen fallc. 8. Kur çdo pozicion shtetëror mbushet me njerëz të poshtër. 9. Kur fjalën kryesore e ka ma i keqi ndër të këqijtë. 10. Kur degjenerimi dhe çoroditja mbërrin majën! Dhe tradhtia është kryefjala e të gjithave. Nëse Zoti nuk dërgon një pejgamer atëherë gjakderdhja është e pashmangshme”, ka shkruar Berisha.

ZGJEDHJET LOKALE NË KOSOVË DO TË MBAHEN MË 12 TETOR

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka caktuar 12 tetorin datë për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta lokale. “Ky vendim është marrë pas shqyrtimit të kujdesshëm të propozimeve të subjekteve politike, si dhe pas një analize të plotë, në përputhje me afatet kushtetuese dhe ligjore”, u tha në njoftimin e Presidencës së Kosovës. Caktimi i kësaj date, sipas Presidencës, synon të mundësojë përgatitje të plotë të procesit zgjedhor nga institucionet përgjegjëse, përfshirë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe

institucionet e tjera relevante, “me qëllim të respektimit të standardeve më të larta të administrimit zgjedhor”. Osmani u ka bërë thirrje subjekteve politike, organizatave dhe shoqërisë civile që t'i qasen “me përgjegjësi të plotë në funksion të garantimit të një procesi gjithëpërfshirës, të rregullt dhe të drejtë”. Më 4 qershor Osmani ishte takuar me përfaqësuesit e partive politike për t'u konsultuar rreth datës për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta lokale. Në takim nuk kishin marrë pjesë përfaqësuesit e Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit. Gjatë këtij takimi ishin përmendur datat 5, 12 dhe 19



tetor për mbajtjen e zgjedhjeve. Zgjedhjet e fundit lokale Kosova i ka mbajtur në tetor të vitit 2021. Lidhja Demokratike e Kosovës kishte fituar në më së shumti komuna, pasur nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës. Caktimi i datës për zgjedhjet

lokale po vjen në kohën kur Kosova është përfshirë në një krizë politike pas zgjedhjeve parlamentare të shkurtit. Që nga votimet ende nuk janë krijuar institucionet e reja, teksa deputetët ende nuk kanë arritur ta konstitujnë Kuvendin e Kosovës, që do t'i hapte rrugë

edhe krijimit të ekzekutivit të ri. Pas takimit konsultues me Osmanin më 4 qershor, përfaqësuesja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, deklaroi se në takim është diskutuar edhe për mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare bashkë me ato lokale.

Haxhiu ka thënë se ajo e ka paraqitur këtë ide, duke shtuar se mbajtja e dy palë zgjedhjeve brenda një dite është përkrahur edhe nga PDK-ja. Megjithatë, për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme është e domosdoshme që të konstituohet Kuvendi dhe më pas, me marrëveshje politike, të shpërndahet ai dhe të shpallen zgjedhjet e reja.



PSE PO KËRKOHET RIKTHIMI I MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE?

Prishtinë, 9 qershor - Që nga viti 2021, kur Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës u shkri në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhjetëra organizata të shoqërisë civile dhe aktivistë kanë paralajmëruar se mirëqenia sociale është lënë jashtë prioritetëve qeveritare.

Fetije Atashi-Hetemi, që lëviz me ndihmën e karrocës, përkrah kërkesën e bërë nga organizatat joqeveritare për rikthimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale, pasi që, siç thotë ajo, “personat në gjendjen më të ndjeshme të shoqërisë duhet të jenë prioritet”.

Që nga viti 2021, kur Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës u shkri në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhjetëra organizata të shoqërisë civile dhe aktivistë kanë paralajmëruar se mirëqenia sociale është lënë jashtë prioritetëve qeveritare, ndërsa qasja në shërbime sociale për kategoritë e cenueshme është përkeqësuar.

Atashi-Hetemi, 56-vjeçare, jeton e vetme dhe thotë se përballet me sfida të shumta në përditshmëri. Që nga fëmijëria e hershme ajo lëviz me ndihmën e karrocës, pasi kishte pësuar dëmtime në tru

për shkak të temperaturës së lartë trupore. Ajo thotë se gjithnjë ka pasur mbështetje nga familja dhe rrethi, gjë që i dha forcë të aktivizohet për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, por kërkon që institucionet t'i përmirësojnë kushtet për këtë kategori të shoqërisë.

Për vite të tëra 56-vjeçarja tregon se ka pasur një ndihmë prej 150 eurosh nga një skemë sociale. Asaj i janë dashur tetë vjet betejë ligjore që ta fitojë pensionin prej 430 eurosh që u takon personave paraplegjikë, por edhe kjo shumë thotë se është e pamjaftueshme për të. “Pensioni që unë marr nuk i mbulon as për së afërmi nevojat e një personi me aftësi të kufizuara, qoftë për barna, vizita mjekësore apo probleme të pritshme, si plagët dekubitale. Me këto para më duhet ta paguaj një asistente që dy herë në javë të më ndihmojë. Nuk kam më shumë mundësi”, thotë ajo për Radion Evropa e Lirë.

Organizatat që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve, thonë se këto grupe të cenueshme, përveç stigmës dhe paragjyqimeve nga shoqëria, gjithnjë e më shumë përballen me mungesë të mbështetjes së qëndrueshme institucionale.

Rikthimi i Ministrisë së Mirëqenies Sociale

Disa muaj më parë, përmes një letre publike drejtuar partive politike në Kosovë, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) ka kërkuar rikthimin e një ministrie të veçantë për mirëqenie sociale. Sipas KOMF-it, një strukturë e tillë është thelbësore për të siguruar qasje dhe koordinim më të mirë të shërbimeve për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, familjet në nevojë dhe kategori të tjera të cenueshme. Por, derisa Kosova, prej muajsh, ndodhet në një krizë të thellë institucionale, kjo temë nuk është trajtuar publikisht nga partitë politike. Sipas të dhënave nga KOMF-i, vetëm 10 për qind e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë kanë qasje në shërbime të mirëfillta shëndetësore dhe sociale.

Ndërkaq, më shumë se 72 për qind e fëmijëve në vend vazhdojnë të disiplinohen përmes formave të dhunshme - një tjetër çështje, që thonë se kërkon përgjigje urgjente nga institucionet.

Përveç fëmijëve, edhe pensionistët, viktimat e dhunës, familjet në ndihmë sociale dhe kategoritë e dala nga lufta janë mes grupeve që, sipas Qendrës për Informim

dhe Përmirësim Social (QIPS), vuajnë mungesën e përkujdesjes institucionale.

Ish-zyrtarë të Ministrisë së dikurshme të Mirëqenies Sociale dhe përfaqësues të shoqërisë civile paralajmërojnë se moskthimi i kësaj ministrie do ta thellojë regresin institucional dhe do të lërë në gjendje të rënduar mijëra qytetarë në nevojë.

Skënder Reçica, që ka udhëhequr atë ministri, thotë se shkrirja e saj në departamente të një super-ministrie “është dëshmi e një moskujdesi të thellë institucionale”. “Shërbimet sociale janë degraduar e qytetari i thjeshtë, që pret ndihmë dhe përkrahje, është lënë në mëshirën e fatit dhe të burokracisë pa shpirt”, thotë Reçica. Sipas tij, rikthimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale “nuk është luks, është domosdoshmëri”. “Ka ardhur koha të thuhet hapur, nuk mund të ekzistojë një shtet social pa një institucion të dedikuar, që i përfaqëson ata që kanë më së shumti nevojë për mbështetje”, thekson Reçica.

Ai shton se disa projekte të nisura nga dikasteri i dikurshëm ministror tashmë kanë dështuar. “Reforma për skemën e ndihmës sociale, e cila ishte në fazë të avancuar të përgatitjes, është braktisur.

Modeli për reformën e sistemit pensional, që synonte drejtësi sociale dhe barazi kontribuuese për të gjithë qytetarët, është harruar. Investimet në shërbimet sociale, të cilat kishin filluar të strukturoheshin, janë ngrirë”, thotë Reçica për Radion Evropa e Lirë.

Rënie e cilësisë së shërbimeve sociale

Për organizatën Handikos Ferizaj, shkrirja e Ministrisë së Mirëqenies Sociale ka krijuar pasiguri tek organizatat joqeveritare, për shkak të paqartësive institucionale dhe mungesës së koordinimit. Sipas kësaj organizate për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, tani ndihet rënia e cilësisë së shërbimeve sociale. “Shkrirja e shërbimeve sociale në ministri të tjera ka sjellë mbingarkesë të stafit dhe shpërndarje jo të qartë të përgjegjësisë, gjë që ka ndikuar në ngadalësimin e hartimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive sociale. Kjo ka krijuar boshllëqe në koordinim dhe ka ulur efektivitetin e mbështetjes për këtë kategori, duke e bërë të nevojshme një qasje më të fokusuar dhe të organizuar në nivel qendror”, thonë nga Handikos Ferizaj. Sipas organizatës, bashkë-

MË PAK NXËNËS DHE STUDENTË SESA NJË VIT MË PARË

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka publikuar statistikën e arsimit për vitin shkollor 2024/2025. Numri i fëmijëve në çerdhe dhe parashkollor për vitin shkollor 2024/2025 ishte 34 038 që, krahasuar me vitin paraprak (2023/2024), që ishte 32 818 fëmijë, kishte një rritje të lehtë të numrit prej 1 220 fëmijë më shumë. Në sektorin publik në

vitin shkollor 2024/2025 ishin 23 349 fëmijë ose 68,6 %, ndërsa në sektorin privat 10 689 fëmijë ose 31,4 %. Krahasuar me vitin paraprak (2023/2024) në sektorin publik ishin 24 104 fëmijë ose 73,4 %, ndërsa në sektorin privat 8 714 fëmijë ose 26,6 %. Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në vitin shkollor 2024/2025 ishte 208 515, prej tyre në sektorin publik ishin 199 190 ose 95,5 % dhe në sektorin privat 9 325 ose

4,5 %. Krahasuar me vitin shkollor 2023/2024, ku numri i nxënësve ishte 215 431, prej tyre në sektorin publik ishin 206 941 ose 96,1 % dhe në sektorin privat 8 490 ose 3,9 %. Nga kjo mund të shohim se sektori publik ka një rënie të numrit të përgjithshëm, kurse sektori privat ka një rritje të lehtë të numrit të nxënësve krahasuar me vitin 2023/2024. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në vitin 2024/2025 ishte 63 551, prej tyre

në sektorin publik ishin 58 337 ose 91,8 %, ndërsa në sektorin privat ishin 5 214 ose 8,2 %. Krahasuar me vitin paraprak 2023/2024 (që ishin 65 757 nxënës, në sektorin publik 60 837 ose 92,5 % dhe në sektorin privat 4 920 nxënës ose 7,5 %) ka rënie të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Rënie më e madhe vërehet te sektori privat, krahasuar me sektorin publik. Numri i përgjithshëm i studentëve në arsimin e lartë në

vitin 2024/2025 ishte 64 817, prej tyre në universitetet publike 36 609 studentë ose 56,5 %, ndërsa në kolegjet private ishte 28 208 studentë ose 43,5 %. Krahasuar me vitin paraprak 2023/2024, që ishin 70 357 studentë, prej tyre në universitetet publike 39 033 studentë, ose shprehur në përqindje 55,5 %, ndërsa në kolegjet private ishte 31 324 studentë ose 44,5 %, ka rënie të lehtë të numrit të përgjithshëm të studentëve.



punimi me Ministrinë e Drejtësisë, ku ndodhet Divizioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ka qenë i mirë, porse nismat për mbështetje të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara thuhet se kanë mbetur me projekte afatshkurtra. “Është e domosdoshme të sigurohet zbatim i efektshëm i Ligjit për shërbime sociale, të zhvillohen programe dhe projekte të qëndrueshme me kohëzgjatje prej tre deri në pesë vjet, të ndërmerren hapa për thjeshtimin e procedurave burokratike dhe të krijohet një mekanizëm i fuqishëm monitorimi për OJQ-të që ofrojnë këto shërbime”, thuhet në përgjigjen e Handikosit për Radion Evropa e Lirë. Handikos Ferizaj përmend edhe mungesën e koordinimit efektiv dhe vonesat në ofrimin e shërbimeve, “duke e bërë edhe më të vështirë jetën e njerëzve në nevojë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e varfra”.

Organizatat e tjera joqeveritare ngrënë edhe një shqetësim tjetër për një kategori tjetër të shoqërisë: fëmijët me autizëm.

Qasja e vështirë në institucionet publike e fëmijëve me autizëm

Lekë Gjurgjiali nga Organizata “Zë” - Qendra Logopedike për Trajtim dhe Huluntim - thekson se në Kosovë është problematike qasja në shërbime profesionale për fëmijët me autizëm. “Qasja në vlerësime logopedike është e vështirë. Edhe qasja në shërbime profesionale logopedike është e vështirë në institucione publike, marrë parasysh numrin e vogël të logopedëve të angazhuar në këto institucione, si dhe koncentrimin e përfshirjes së logopedëve në institucione publike vetëm në Prishtinë”, thotë ai. Për Gjurgjialin edhe më shqetësuese është lista e gjatë e pritjes për fëmijët që duan të

marrin trajtim në sektorin publik. “Listat e pritjes në institucione publike si dhe kostot e trajtimit në sektor privat dhe në organizata joqeveritare janë problematike. Vetëm një numër i vogël i organizatave joqeveritare ofrojnë shërbime pa pagesë”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Gjurgjiali beson se rikthimi i Ministrisë së Mirëqenies Sociale do të përmirësonte edhe bashkëpunimin ndërsektorial në mes të institucioneve qeveritare dhe organizatave të shoqërisë civile, që merren me mbrojtjen e fëmijëve dhe gjithpërfshirjen e tyre. Për Bind Skejën, nga Qendra për Informim dhe Përmirësim Social, bashkimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me ministri të tjera ka shkaktuar konfuzion brenda institucioneve, ku “s’ka qenë e qartë ndarja e përgjegjësi”. Ai vlerëson se në këtë shkrirje të ministrisë, ka humbur edhe “dija institucionale”, meqë përgjegjësitë për shërbime

sociale kanë shkuar tek entitetet, “të cilat nuk e kanë në bazë kauzën sociale, por operojnë me prioritete tjera”. “Shembull konkret është transferimi i shërbimeve të shëndetit mendor në Ministri të Shëndetësisë. Kujdesi ndaj individëve me probleme të shëndetit mendor tejkalon trajtimin medikamentoz dhe kërkon programe të mbështetjes sociale, si banimi/strehimi, punësimi, rehabilitimi etj. Këto janë jashtë vizionit të Ministrisë së Shëndetësisë, gjë që pengon mundësinë për formimin e një sistemi të mirëfilltë të kujdesit të shëndetit mendor”, thotë Skeja. Ai, po ashtu, shpreh kritika sa i përket mungesës së ndonjë nisme sociale dhe të kujdesit për shëndetin mendor. “Shërbimet sociale kërkojnë ekip të veçantë që kupton sistemin dhe e ka përmirësimin e sistemit synim parësor, deri në pikën ku arrihet barazia sociale”, thekson Skeja. Në vitin 2021, kur Lëvizja Vetëvendosje e mori pushtetin,

vendosi që përmes reformave qeveritare ta shkurtojë numrin e ministrive për t’i ulur shpenzimet operative dhe për të arritur një efikasitet administrativ. Radio Evropa e Lirë ka dërguar pyetje në adresën e Lëvizjes Vetëvendosje për të marrë një qëndrim karshi thirrjeve për rikthimin e ministrisë, mirëpo deri në publikimin e këtij teksti ky subjekt politik nuk ka kthyer përgjigje. As partitë e tjera politike nuk u janë përgjigjur pyetjeve të Radios Evropa e Lirë për këtë temë. Për dallim nga Kosova, shumica e shteteve në rajon kanë ministri të veçantë për mirëqenien sociale. Në Shqipëri, çështjet e mirëqenies sociale trajtohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në Mal të Zi, institucion përgjegjës për këtë është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. E, në Serbi ekziston Ministria e Punës, Punësimi, Çështjeve të Veteranëve dhe Çështjeve Sociale si organ për shërbimet e mirëqenies sociale.

NË BE JANË TË SHQETËSUAR PËR SIGURINË, NË BALLKAN PRIORITET MBIJETESA



PRISHTINË, 9 QERSHOR - Qytetarët e Bashkimit Evropian dhe të Ballkanit Perëndimor kanë prioritetet dhe pikëpamje të ndryshme jetësore, tregon një anketë e Eurobarometrit e kryer në pranverë të këtij viti. Derisa ata të BE-së mbeten të përqendruar në çështje të sigurisë që lidhen me pushtimin rus të Ukrainës, në Ballkanin Perëndimor më të shqetësuar janë për rritjen e çmimeve të ushqimeve, krimin, korrupsionin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor. Anketa shpërfaq, gjithashtu, dallime mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, sidomos Serbisë dhe pjesës tjetër të rajonit, për sa i përket optimizmit, besimit në BE, mosbesimit në NATO dhe mbështetjes për anëtarësimin e mundshëm. Për tre vjet me radhë më shumë se një e katërta e të anketuarve nga 27 vende pajtohen se lufta në Ukrainë përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë e BE-së, ndërsa një e pesta i jep përparësi mbrojtjes dhe sigurisë. Ballkani Perëndimor, në anën tjetër, përqendrohet te mbijetesa e përditshme. Krahastuar me anketën e njëjtë

të kryer në vjeshtë, Maqedonia e Veriut regjistroi rritjen më të madhe të shqetësimeve në lidhje me krimin, ndërsa Kosova regjistroi rritjen më të madhe të shqetësimeve në lidhje me rritjen e çmimeve. Kosova dallohet krahasuar me pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor për optimizmin, ku 76 për qind e të anketuarve shprehën të kënaqur me tregun e punës. Rreth 40 për qind e të anketuarve në vendet e tjera mendojnë se mundësia për të gjetur punë në vendin e tyre është e mirë, që është në përputhje me mesataren e Bashkimit Evropian. Krahastuar me sondazhin e Eurobarometrit në vjeshtë, Shqipëria shënon rritjen më të madhe të optimizmit - për 17 për qind, ndërsa Bosnjë-Hercegovina rritjen më të madhe të pesimizmit - për 6 për qind. Sa i përket gjendjes së përgjithshme në vend, dy të tretat e të anketuarve në Serbi mendojnë se ajo është e keqe. Njëkohësisht, kjo është edhe rritja më e madhe e perceptimit negativ: 19 për qind. Ndryshe nga të tjerët, 80 për qind e të anketuarve në Kosovë

e kanë vlerësuar gjendjen në vendin e tyre si të mirë. Pesimizmi për këtë çështje është rritur më së shumti në Serbi - për 19 për qind - krahasuar me tetorin e vitit 2024. Të anketuarit në Kosovë dhe në Mal të Zi janë optimistë sa i përket drejtimit që po ndjekin vendet e tyre. Ndërkohë, në Bosnjë-Hercegovinë është rritur ndjeshëm pesimizmi - 14 % më shumë njerëz se në vjeshtën e vitit 2024 mendojnë se vendi është në rrugë të gabuar. Rritje e ngjashme e mendimit negativ është shënuar edhe në Serbi, 11 %. Ndërsa shumica e qytetarëve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor besojnë se jeta e tyre nuk do të ndryshojë vitin e ardhshëm, në Kosovë dhe në Shqipëri dominon optimizmi. Në këto dy vende shumica besojnë se jeta e tyre do të përmirësohet, ndërsa çdo i pesti i anketuar në Serbi dhe në Maqedoni të Veriut ka frikë se e ardhmja do të jetë më e vështirë. Në krahasim me të njëjtën anketë të kryer në vjeshtën e vitit 2024, në Mal të Zi është rritur për 20 për qind numri i

atyre që mendojnë se gjithçka do të mbetet e njëjtë, ndërsa në pjesën tjetër të rajonit rezultatet janë afërsisht të njëjta. Në Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë, shumica e qytetarëve parashikojnë përkeqësim të situatës së përgjithshme në vendet e tyre gjatë vitit të ardhshëm. Kosova dhe Shqipëria dallojnë nga ky trend, pasi shumica e të anketuarve presin përmirësim në të ardhmen, madje më shumë se në vjeshtën e kaluar. Pesimizmi është rritur më së shumti në Bosnjë-Hercegovinë për 6 për qind. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian, ndërkaq, mbetet i dëshirueshëm për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, përveç Serbisë. Entuziazmi është më i lartë në Shqipëri dhe Mal të Zi, ku shumica e të anketuarve besojnë se anëtarësimi do të sjellë përfitime për vendet e tyre. Në Serbi mendimet për anëtarësimin në BE janë të ndara në mënyrë të barabartë midis atyre që e përkrahin, e kundërshtojnë ose janë indiferentë. Në Mal të Zi është shënuar rritja më e madhe e optimizmit për


anëtarësim në BE krahasuar me anketën e mëparshme të vjeshtës - për 13 për qind. BE-ja gëzon besim të madh në Mal të Zi, Shqipëri dhe Kosovë - gjë që përputhet me orientimet e tyre proevropiane. Në anën tjetër, 57 për qind e të anketuarve në Serbi thonë se nuk besojnë në BE. Sa iu përket qytetarëve të BE-së, 52 për qind besojnë në institucionet evropiane, ndërsa 41 për qind nuk besojnë. Në krahasim me anketën e mëparshme, besimi ka mbetur thuajse i pandryshuar - me një rritje për 9 për qind në Kosovë. Mungesa e besimit ndaj NATO-s në Serbi është edhe më e theksuar, ku 92 për qind e të anketuarve nuk besojnë në këtë organizatë. Ndryshe është situata në Kosovë, ku 95 për qind e njerëzve shprehin besim në NATO. Shumica e qytetarëve të BE-së dhe mbi 60 % e banorëve të Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut - të dyja vende anëtare - kanë besim në Aleancën Veriatlantike. Rritja më e madhe e besimit në NATO është regjistruar në Bosnjë-Hercegovinë - për 11 për qind. (REL)

LDK-së i bashkohet asamblistja e AAK-së në Suharekë

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mirëpritur në radhët e veta Sanie Kuqi - Rexhepaj. Ajo ka qenë anëtare e Këshillit të Përgjithshëm të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe asambleiste e kësaj partie

në Asamblenë Komunale të Suharekës. Ajo tashmë i është bashkuar zyrtarisht LDK-së dhe degës së saj në Suharekë. Në një takim të mbajtur të hënën, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, së bashku

me kryetarin e degës në Suharekë, Ardian Shala, e kanë pritur në takim Rexhepajn, duke i shprehur mirëseardhje dhe vlerësim për kontributin e deritanishëm në jetën publike dhe institucionale të komunës.



Shkoj Baca Rexhë!

Ju kam treguar për Rexhep Gali Balidemajn kur i mbushi 100 vjetët e jetës.

Jetoi edhe dy vjet e gjysmë më shumë, por gjithmonë me zemër djaloshare, i papërsëritshëm, encikloped i patriotizmit natyral, tërësisht i paimponueshem dhe joekspozues.

Asnjë okupim dhe asnjëra nga 13 burgosjet në

Jugosllavi lirinë e zemrës nuk ia tundi, se liria aty rron. “Nëse asgjë nuk mund t’u bëni policëve serbë, futjuni nga një guralec në këpucë, të paktën të çatallojnë...”, na thoshte ne të rinjve në burg, ndërkohë që ditë as natë nuk lodhej së recituari aq frymëzueshëm Fishtën e Madh. Askush nuk ia kalon!

Trupi i tij meriton të kthehet në atdhe dhe të pushojë në një Panteon kombëtar, që duhet ta unisojmë.

Ngushëllime familjes së madhe Balidemaj dhe patriotëve anembanë trojeve!

Nderime pa kufi, Baca Rexhë!

(Muhamet MAVRA)



KOMANDANTI I FSK-së MERR PJESË NË DITËN E VIZITORËVE TË SHQUAR NË SHQIPËRI

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Me rastin e përmbylljes të Ushtrimit Fushor (UF) “Defender Europe 25”, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (KOMFSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari, mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar (DV Day) në Republikën e Shqipërisë.

Fillimisht, gjeneral Jashari u prit nga Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSh), gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili e njoftoi për rrjedhën e ushtrimit dhe nivelin e lartë të bashkëpunimit ndërmjet FARSh dhe njësive të FSK-së të angazhuara në kuadër të Brigadës Shumëkombëshe të



Lindjes (MNB-E).

Gjatë kësaj vizite GLT Jashari vizitoi trupat e kontingjentit të FSK-së të angazhuar në

Republikën e Shqipërisë, i përbërë nga Togu i mortajave, vlerësuesit dhe oficerët e shtabeve në kuadër të

komandës së brigadës, ku u njoh nga afër me zhvillimet e aktiviteteve të përbashkëta dhe arritjet gjatë këtij ushtrimi. Ai i përgëzoi pjesëmarrësit për përkushtimin e tyre gjatë kësaj kohe, duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së FSK-së në një ushtrim të nivelit të DE25, si dhe ngritjen e aftësive të njësive të FSK-së që të operojnë në një mjedis shumëkombësh operacional.

Sipas agjendës, personalitetet e larta kanë ndjekur demonstrimin e aktiviteteve të planifikuara në poligonin trajnues Biza. Forcat e FARSh, Ushtrisë Amerikane, FSK-së, Maqedonisë së Veriut dhe

Kroacisë, të angazhuara në këtë ushtrim, shfaqën një performancë të dalluar gjatë ekzekutimit të aktiviteteve të planifikuara, të cilat kanë përfshirë edhe qitjen me mortaja nga togu i mortajave të KFT-së.

Dislokimi i njësive të FSK-së në brigada të ndryshme të rajonit në ushtrime fushore të këtij niveli përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt avancimit të ndërveprueshmërisë me aleatët dhe partnerët dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve operacionale të FSK-së të operojë në mjedise shumëkombëshe.

SHTETASIT E HUAJ MUND TË APLIKOJNË ONLINE PËR LEJE QËNDRIMI NË KOSOVË

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Divizioni për të Huaj në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) ka njoftuar se nga sot, 9 qershor, ka rifilluar aplikimi për caktimin e terminëve për leje qëndrimi për shtetasit e huaj përmes platformës digjitale e-Kosova. Sipas MPB-së, kjo mundësi synon ta lehtësojë procesin e aplikimit, t’i eliminojë pritjet e gjata dhe ta sigurojë

respektimin e të drejtave të shtetasve të huaj të cilët kërkojnë leje qëndrimi në Republikën e Kosovës. “Kjo mundësi ka për qëllim lehtësimin e procesit të aplikimit për leje të qëndrimit nga shtetasit e huaj, eliminimin e pritjeve të gjata përmes rezervimit të terminit dhe respektimin e të drejtave të shtetasve të huaj”, thuhet në njoftim.



MPB thekson se rezervimi i terminit është i domosdoshëm për të gjithë ata që kërkojnë leje të re qëndrimi apo që duan

ta vazhdojnë lejen aktuale në mënyrë që të respektohen afatet ligjore. “Qytetarët-shtetasit e huaj kanë mundësinë e respektimit të afateve ligjore, para se të kalojnë ditët e caktuara të qëndrimit 90 ditë, apo të cilët e vazhdojnë lejen e qëndrimit, të organizojnë kohën e tyre të terminit brenda afatit 30 ditë para skadimit të saj”, thuhet në njoftim.

Ministria ka theksuar përkushtimin e saj për shërbime cilësore dhe digjitalizim të proceseve, duke u shprehur se po punon vazhdimisht për të krijuar lehtësira për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për të caktuar termin për leje qëndrimi, të interesuarit mund të aplikojnë përmes platformës zyrtare: Platforma eKosova - Lejeqëndrim.

Kosova në Expo Osaka 2025

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Republika e Kosovës po përfaqësohet në Expo Osaka 2025, Kansai, Japoni, përmes një bashkëpunimi të ngushtë ndërinstitucional.

Liza Gashi, zëvendësministre në detyrë e jashtme, ka thënë se si udhëheqëse e Komisionit Ndërshtetëror për këtë projekt të menaxhuar nga qeveria, ndihet shumë e lumtur që për herë të dytë Kosova është pjesë e kësaj ngjarjeje botërore, e cila ofron një mundësi të jashtëzakonshme për ta

paraqitur kulturën, trashëgiminë, si dhe potencialin ekonomik dhe zhvillimor që ofron vendi ynë. “Pavijoni i Kosovës në Osaka është konceptuar si një hapësirë mikpritëse, ku vizitorët nga Japonia dhe nga mbarë bota do të kenë mundësi të njohin nga afër Kosovën. Gjatë muajve në vijim, pavijoni ynë do të ofrojë mundësi të shumta për promovimin e potencialit tonë dhe ndërtimin e një imazhi të denjë të vendit në atë pjesë të botës. Veçanërisht gëzohemi që

në Ditën Kombëtare të Kosovës në Expo, më 11 qershor, do të marrin pjesë Presidentja e Republikës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, si dhe Filharmonia dhe Baleti i Kosovës, me një program dinjitoz artistik dhe kulturor. Një falënderim i veçantë shkon për ekipin ndërinstitucional të Expo-s dhe komisionerin z. Arbër Mehmeti, si dhe për Ambasadën e Republikës së Kosovës në Japoni, të udhëhequr nga Shefi i Misionit, ambasadori z. Sabri Kicmari”, ka shkruar ajo në “Facebook”.



Gërxhaliu: Rritja e çmimeve nuk do të ndalet

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka folur për “Front Online” rreth rritjes së çmimeve, duke e lidhur këtë trend me krizën institucionale dhe ngarkesën politike në vend. Sipas tij, rritja e çmimeve po ndodh pa kontroll. “Ngritja e çmimeve po ndodh kur agjenda politike është e ngarkuar dhe nuk ka

institucione të dala nga qytetarët. E tëra kjo po e dëmton ambientin biznesor dhe kjo po krijon një anarki që po zhvillohet nga të gjithë. Pas rritjes së çmimit të rrymës, nuk duhet të na habitë fakti se do të kemi rritje të çmimit të bukës dhe produkteve të tjera”, ka thënë ai. Ai kërkoi që inspektoratet të veprojnë më me përgjegjësi

dhe në funksion të interesit publik, jo si instrumente të agjendave politike. “Agjencia e Konkurrencës sot më shumë është në shërbim të ruajtjes së pushtetit të partisë fituese sesa në interes të qytetarëve. Inspektorati duhet të jetë më aktiv, jo ta përmbushë agjendën e saj, por të jetë në shërbim të qytetarëve”, tha Gërxhaliu.



HAPET PANAIRI NDËRKOMBËTAR “PRISHTINA 2025”, OEK-U FTON BIZNESET PËR PJESËMARRJE

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Oda Ekonomike e Kosovës është gati t’i mirëpresë vizitorët dhe ekspozuesit në Panairin e Përgjithshëm Ndërkombëtar “Prishtina 2025”, i cili fillon të martën në orën 11:00 në qendrën tregtare Prishtina Mall. Ky panair, i cili do të zgjasë tri ditë, është një ngjarje e rëndësishme ekonomike, duke ofruar një platformë të pasur për zbulimin e produkteve, shërbimeve dhe inovacioneve të reja nga një gamë e gjerë sektorësh ekonomikë. “Prishtina 2025” ka për qëllim t’i mbështesë dhe zhvillojë të gjitha aspektet e ekonomisë, duke mbledhur së



bashku ekspozues nga Kosova, rajoni dhe bota. Ky është një nga panairët më të rëndësishëm të vitit në vend,

duke krijuar një mundësi të shkëlqyer për promovimin e produkteve dhe shërbimeve, si dhe për të ndërtuar partneritete

të reja dhe për ta zgjeruar shtrirjen në tregjet ndërkombëtare. Gjatë tri ditëve të panairit vizitorët do të kenë mundësinë të zbulojnë produkte të dizajnuara për t’i shfaqur risitë më të fundit dhe ofertat unike nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë teknologjinë, bujqësinë, industrinë e prodhimit, turizmin dhe shumë të tjera. Pjesëmarrësit do ta kenë mundësinë të lidhen me liderë të industrisë, investitorë dhe profesionistë të tjerë, duke promovuar shkëmbimin e ideve dhe krijimin e mundësive të reja biznesi. Panairi “Prishtina 2025” është

një tregues i angazhimit të Kosovës për ta forcuar pozicionin e saj në tregjet ndërkombëtare dhe për ta nxitur zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Për të gjithë ata që kërkojnë ta rritin ndikimin e tyre në ekonominë globale, ky panair ofron një mundësi të jashtëzakonshme për të eksploruar dhe për të krijuar lidhje të reja në një ambient dinamik dhe të frytshëm. OEK-u fton të gjitha bizneset e interesuara të marrin pjesë në këtë ngjarje madhore, duke përfituar nga ekspozimi dhe rrjetëzimi me përfaqësues të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë.

RIZVANOLLI VIZITOI SHKOLLAT ‘ISA BOLETINI’ DHE ‘HAMIT SEJDIU’, SHEH INVESTIMET NË EFIÇIENCË TË ENERGJISË

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, së bashku me nënkryetaren e Podujevës, Marigona Lahu dhe drejtorin e Drejtorisë së Arsimit në këtë komunë, Avni Fetahu, e kanë vizituar shkollën “Isa Boletini” në Pakashticë dhe shkollën “Hamit Sejdiu” në Podujevë, ku janë duke u bërë investime në eficiency të energjisë. Në ndërtesat e këtyre shkollave po punohet në izolimin e çatave dhe mureve të jashtme, ndërrimin e dyerve dhe dritareve, instalimin e sistemeve të ngrohjes eficiente dhe vendosjen e ndriçim efikas me LED.



Projekti implementohet nga Fondi i Kosovës për Eficiency të Energjisë dhe financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes skemës qarkulluese për komuna. Me

këtë rast, ministrja Rizvanolli theksoi se investimet në eficiency të energjisë përkthehen në kushte më të mira për nxënësit dhe mësimdhënësit, në klasa më të ngrohta, më të

ndriçuara dhe më të sigurta. “E kështu në komunën e Podujevës po u japim prioritet kushteve më të mira për nxënësit dhe mësimdhënësit, përmes një reforme të thellë në infrastrukturën shkollore dhe eficiency të energjisë. Në total janë renovuar dhe duke u renovuar 8 shkolla publike, me një investim të përgjithshëm prej mbi 1.48 milionë eurosh dhe përfitojnë 2 275 nxënës e mësimdhënëses”, tha Rizvanolli dhe shtoi se me një investim prej 745 mijë eurosh, aktualisht janë duke u renovuar 4 shkolla, të cilat do të përfundojnë në shtator 2025 dhe pas përfundimit pritet kursim i energjisë mbi 70

%, që do të ndikojë drejtpërdrejt në buxhetin e komunës dhe në cilësinë e jetës në shkollë. Në ShFMU “Isa Boletini” po investohen 361 420 euro, ku janë 1 413 përfitues, ndërsa në ShFMU “Hamit Sejdiu” po investohen 115 497 euro dhe nga këto investime janë 90 përfitues. Po ashtu, investimet janë duke u realizuar edhe në shkollat “Ali Ajeti” në Lladovc dhe “Shefki Kuleta” në Tërnavë. Investimet në eficiency të energjisë kanë përfunduar në katër shkolla: në shkollat “Shaban Shala” dhe “Enver Maloku” në Podujevë, “Shefki Kuleta” në Bellopojë dhe “Luigj Gurakuqi” në Gërdoc.

1.7 milion vezë tërhiqen nga tregu pas shpërthimit të salmonelës në ShBA

UASHINGTON, 9 QERSHOR - Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve dhe Administrata Amerikane e Ushqimit dhe Barnave po hetojnë një shpërthim të salmonelës në shumë shtete të ShBA-së që dyshohet se erdhi nga vezët. Vezët u shpërndanë nga Kompania e Vezëve August nga 3 shkurti deri më 15 maj te shitësit me pakicë në nëntë

shtete: Kaliforni, Nevada, Uashington, Arizona, Nebraska, New Mexico, Illinois, Indiana dhe Wyoming, sipas FDA-së, shkruan AP. Në një njoftim të lëshuar të premtën, kompania e shpërndarjes me bazë në Hilmar, Kaliforni, tërhoqi 1.7 milion vezë nga tregu, të cilat kanë data skadimi që variojnë nga 4 marsi deri më 19

qershor dhe u shitën te shitës me pakicë, duke përfshirë Walmart dhe Safeway, me shumë marka të ndryshme. Deri më tani raportohet se janë sëmurë 79 persona në New Jersey, Kentucky, Nebraska, Nevada, Arizona, shtetin e Uashingtonit dhe Kaliforni, tha CDC. Të paktën 21 persona janë shtruar në spital dhe nuk ka raportime për vdekje.



MUSK 'I LA SHËNDENË'. FUNDI I NJË EKSPERIMENTI





Shënimi i mëngjesit nga Washingtoni i faqes Politico.com hapet duke cituar zhurmën e tapave të shampanjës që janë hapur, në kryeqytet, pas njoftimit të largimit të Elon Musk nga qeveria e Donald Trumpit. Sipërmarrësi kishte njoftuar prej kohësh tërheqjen e tij: duke qëndruar në administratë për më shumë se 130 ditë, ai do të ishte bërë një punonjës me kohë të plotë me të gjitha detyrimet e transparencës dhe të rregullave të konflikteve të interesit, të cilave nuk kishte ndërmend t'u nënshtrohej. Pra, në dukje, një ndarje e dakordësuar, jo një përçarje. Vetë Musk e ka një siguri: farat e mbjella me Doge, ministria i tij për Efiçencën, do të japin frytet e tyre në reduktimin e burokracisë dhe të shpërdorimeve. Por, duke çmontuar sektorë të tërë të administratës publike, Elon kishte kundër jo vetëm personelin, gjysmën e qeverisë, por edhe një pjesë të mirë të Kongresit – përfshirë republikanët. Me popullaritetin që i kishte rënë ndjeshëm, edhe Trumpi kishte pushuar së lavdëruari me elozhe të

ekzagjeruara. Tani pyesim se çfarë do të ndodhë me atë ministri që duhej të transformonte makinerinë shtetërore, të përbërë nga njerëz që ai vetë i kishte zgjedhur dhe punësuar. Doge tashmë është nën hetim nga gjyqësori, i cili ka kontestuar shumë largime të konsideruara të paligjshme: më pak pengesa, tani, për gjyqtarët. Për më tepër, ëndrra e Musk për të ulur shpenzimet publike me 2.000 miliardë dollarë, më pas 1.000, kishte dështuar prej kohësh: e gjitha ishte reduktuar në 150 miliardë. Por as ky rezultat nuk ka mbetur: brenda asaj shume janë eliminuar disa shpenzime të krijuara më parë dhe funksione të ndryshme që qeveria i kishte eliminuar gabimisht, por që tashmë po rikthehen me shpejtësi. Çfarë do të mbetet nga ky eksperiment? Ndoshta vetëm një shans kaotik i humbur nga një sipërmarrës gjeni dhe dinamik, por pa përvojë politike dhe pa empati, që – pasi doli në skenën e Uashingtonit duke mbajtur një sharrë elektrike – largohet sot pothuajse në heshtje me një tweet. Pothuajse, sepse, pikërisht

ndërkohë që falënderon në X presidentin për mundësinë e dhënë për të zbatuar me DOGE masa të rishëndoshjes së financave publike, Musk jep një intervistë për CBS, ku godet ligjin e buxhetit të Trumpit, duke pohuar se ai rrit deficitin dhe borxhin federal në vend që t'i ulë ato; pra, e anulon punën e DOGE. Me pak fjalë, Trump nuk e prish marrëdhënien me Musk, i cili ka bërë më shumë se kushdo tjetër për rizgjedhjen e tij, dhe Elon nuk e sulmon drejtpërdrejt një president që ka në dorë mekanizmat qeveritarë, në gjendje të ndikojnë ndjeshëm në ndërmarrjet e tij, duke i mbështetur ose penguar ato. Por është i qartë zhgënjimi i Musk dhe një zemërim i papërmbytur për faktin që nuk arriti të ndalonte marrëveshjen më të hidhur: atë për të krijuar në Abu Dhabi një nga qendrat më të mëdha të të dhënave në botë për inteligjencën artificiale, të firmosur nga kreu i OpenAI, Sam Altman, armiku i tij i betuar, së bashku me Nvidia, Oracle dhe një Softbank. Sipërmarrësi fillimisht u përpoq të pengonte bashkëpunimin,

më pas u tha të dërguarve të Emirateve se operacioni nuk do të përfundonte me sukses nëse nuk merrte pjesë edhe kompania e tij xAI. Por në fund Trump bekoji marrëveshjen pa pjesëmarrjen e Musk. Pra, asnjë derë nuk u përplas me të madhe, por ai «bashkëpresident» që ende në shkurt thoshte se e donte Trumpin dhe që tani tërhiqet heshturazi, nuk do të largohet krejtësisht në heshtje nga skena. Komunikues pa frena, sipërmarrësi i Tesla, X dhe SpaceX që ka shpenzuar gati 300 milionë dollarë për të zgjedhur Trumpin dhe kishte premtuar edhe 100 të tjerë për zgjedhjet e mesit të mandatit në vitin 2026, ka thënë se është lodhur shumë nga politika: “Tani mjaft më, nuk do të jap më asnjë dollar përveçse nëse shoh ndonjë përfitim: ‘Për momentin nuk shoh asnjë.’” Pyetja kryesore ka të bëjë me rindërtimin e koalicionit që i dha Trumpit mjetet për të ndërhyrë në të gjitha fushat, duke qeverisur në mënyrë autoritare. Ai kishte krijuar një ekuilibër midis së djathtës ultrakonservatore të Heritage Foundation dhe pjesës së botës

së teknologjisë, e cila i ishte bashkuar si aleate. Tërheqja e Musk lë në skenë vetëm tradicionalistët? Apo Musk, Thiel, Andreessen dhe të tjerë liderë të botës digjitale, të vetëdijshëm për mësimin e 8 viteve më parë dhe pasi kanë vendosur shumë njerëz të tyre në poste kyçe të administratës, presin në pritë një Trump ende të aftë dhe të papërballueshëm, por me një horizont të kufizuar? Teknologjia, gjithnjë e më e fuqishme dhe së shpejti e destinuar, me Inteligjencën Artificiale, të revolucionarizojë tregun e punës duke krijuar probleme të mëdha për politikën — siç paralajmëron edhe kreu i Anthropic, Dario Amodei — sigurisht nuk heq dorë nga ambicia e saj për të ndryshuar rregullat e demokracive. Ajo e përdorimit të Trumpit si një buldozer rezultoi një iluzion. Tani loja do të luhet me JD Vance: «kapiteni i së ardhmes» është një krijesë e Thiel, por ka flirtuar edhe me ultra-t e Heritage. Çfarë do të bëjë ai kur (dhe nëse) Trumpi do t'i lërë fushë të lirë? / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Shtatë vjet pa legjendën Fadil Vokrri

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Janë bërë shtatë vjet që nga ndarja prej jetës e legjendës së futbollit, Fadil Vokrri. Ai ishte një nga futbollistët më të mirë shqiptar dhe është më meritor për formimin e Kombëtares së Kosovës në futboll dhe për pranimin e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) në UEFA dhe FIFA.

Fadil Vokrri, i cili ka qenë kryetar i FFK-së në atë kohë, menjëherë pas votimit kishte shprehur emocione për këtë arritje. "Jam shumë i prekur. Ju falënderoj para së gjithash në emër të lojtarëve të rinj të vendit tim për këtë vendim. Kjo është një ditë historike për ne", kishte thënë Vokrri, pasi 28 anëtare të UEFA-s patën votuar për, 24 kundër, ndërsa dy vota kishin qenë të pavlefshme.

Vokrri e kishte udhëhequr FFK-në për mbi një dekadë, përfshirë në kohët më të vështira të federatës, siç janë proceset e pranimit në UEFA e FIFA. Në vitin 2016 FFK-ja ishte pranuar në shtëpitë e futbollit botëror dhe evropian falë Vokrrit.

Vokrri të hënën është përkujtuar nga pasardhësi i tij, Agim Ademi. Ai ka thënë se 9 qershori i vitit 2018 mbetet një nga datat më të dhimbshme për komunitetin e futbollit në Kosovë. "Ndarja nga jeta e Fadil Vokrrit na la pa ikonën tonë më të madhe, por trashëgimia që ai na la pas vazhdon të na frymëzojë çdo ditë. Fadil Vokrri ishte më shumë se një futbollist. Ai ishte mishërim i pasionit,

përkushtimit dhe dashurisë së pakushtëzuar për futbollin dhe për vendin. Me talentin e dhuruar nga Zoti dhe me përkushtimin që e karakterizonte në çdo hap të jetës, ai fitoi zemrat e të gjithëve, që nga ditët e para me fanellën Llapit e Prishtinës, e deri te paraqitjet në skenën ndërkombëtare. Aftësitë me topin, vizioni në lojë dhe karizmi i tij bënë që ai të shndërrohej në idhull për tifozët dhe një model për shumë breza të futbollistëve", ka thënë Ademi, duke shtuar se kontributi i Vokrrit për futbollin nuk kishte përfunduar me mbylljen e karrierës si lojtar. "Pas disa vitesh të kaluara në Francë, ku jetoj me familjen, ai vendosi të rikthehej në atdhe, fillimisht me misionin për të ngritur profesionalizmin në klubin ku u bë i famshëm, KF Prishtina, e më pas për të marrë udhëheqjen e futbollit të Kosovës. Me autoritetin që gëzonte dhe me mbështetjen e të gjithë komunitetit të futbollit, Fadil Vokrri e udhëhoqi misionin historik të anëtarësimit të Kosovës në UEFA dhe FIFA. Ai e trasoi rrugën e nisur nga ish-kryetarët e FFK-së, Agim Bytyqi, Rexhep Abdullahu e Sabri Hashani, së bashku me bashkëpunëtorë të palodhshëm. Me përpjekje të pandalshme dhe me përkrahjen e institucioneve vendore dhe faktorëve ndërkombëtarë, Kosova arriti më në fund të bëhet anëtare e UEFA-s dhe



FIFA-s në maj të vitit 2016 në Budapest", ka thënë Ademi. Më tutje, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka thënë se shtatë vjet pas ndarjes së tij nga jeta, kujtimi për Fadil Vokrrin është më i gjallë se kurrë. "Ai mbetet ikonë e futbollit mbarëkombëtar dhe një figurë që do të jetojë përherë në historinë e sportit tonë. Në këtë ditë përkujtimore i shprehim mirënjohjen më të thellë për gjithçka që bëri për futbollin dhe për Kosovën. Karriera e tij si futbollist ka qenë dhe mbetet udhërrëfyes për brezat e rinj. Le të shpresojmë që në këtë ditë përkujtimi, në stadiumin që me

krenari mban emrin e tij, Kosova do ta arrijë fitoren e radhës kundër Komoreve, si një dedikim i denjë për legjendën. I përjetshëm kujtimi!", ka thënë Ademi. Në nderim të jetës dhe kontributit të legjendës së futbollit, Fadil Vokrri, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, së bashku me mikun e madh të futbollit kosovar dhe përkrahësin ndërkombëtar të Kosovës, Jerome Champagne, si dhe bashkëpunëtorët Bakir Burri, Ismajl Ajeti, Muharrem Sahiti, Samir Ujkani dhe Lulzim Berisha, kanë bërë homazhe dhe vendosur buqeta me lule në varrin e Vokrrit.

Rashica drejt rikthimit në Bundesliga

BESARTËS, 9 QERSHOR - A do të rikthehet Milot Rashica në Bundesligë pas katër vitesh mungesë? Sipas gazetarit turk Safak Malatya, disa klube gjermane kanë shprehur interesim për sulmuesin anësor nga Kosova. Rashica aktualisht është pjesë e Beshiktashit, ku ka bërë një sezon të mirë. Ai është transferuar nga Werder Brementi te Norwich City në vitin 2021 për 11 milionë euro, përpara se të kalonte në Superligën turke.

Ndër skuadrat e interesuara për shërbimet e tij përmendet veçanërisht Borussia Mönchengladbach, e cila po kërkon alternativa në repartin ofensivë. Kjo lidhet me përgatitjet për një largim të mundshëm të Alassane Plea, sulmuesit francez 32-vjeçar, i cili pritet të largohet nga klubi gjatë afatit kalimtar veror. Rashica ka regjistruar 5 gola dhe 12 asistime në 41 ndeshje zyrtare me fanellën e

Beshiktashit në edicionin 2024/25, duke qenë një nga lojtarët me kontributin më të madh te skuadra turke. Sipas vlerësimeve të fundit në tregun e transferimeve, vlera e tij është rreth 7.5 milionë euro, ndërsa ka kontratë të vlefshme me Beshiktashin deri në vitin 2027. Një rikthim i mundshëm në Bundesligë do të ishte një hap interesant në karrierën e Rashicës, por për momentin nuk ka ende ndonjë ofertë konkrete në tavolinë.



Gyokeres mposht Ronaldon, shpallet golashënuesi më i mirë i Ligës së Kombeve



Munih, 9 qershor - Sulmuesi suedez Viktor Gyokeres është shpallur golashënuesi më i mirë i Ligës së Kombeve UEFA për sezonin 2024/25. 27-vjeçari ka shënuar në pesë nga gjashtë

ndeshjet e fazës së ligës në Grupin 1 të Ligës C, përfshirë një performancë me katër gola në një ndeshje në shtëpi kundër Azerbajxhanit. Ai, gjithashtu, ka dhënë pesë

asiste, më e larta në turne, duke kompletuar një sezon fantastik. Gyokeres kryeson listën e golashënuesve me nëntë gola, vetëm një më shumë se Cristiano Ronaldo, me Portugalinë, e cila

ka mposhtur Spanjën në gjuajtjet e penaltive në finalen e Ligës së Kombeve. Erling Haaland i Norvegjisë dhe Georges Mikautadze i Gjeorgjisë kanë shënuar nga shtatë gola secili,

ndërsa Razvan Marin i Rumanisë ka kompletuar pesëshen e parë me gjashtë gola. Ronaldo është bërë lojtari më i vjetër që ka luajtur ndonjëherë në një finale të Ligës së Kombeve.


Lewandowski tërhiqet nga Kombëtarja e Polonisë për shkak të përplasjeve me trajnerin

VARSHAVË, 9 QERSHOR - Ylli më i madh i futbollit polak, Robert Lewandowski, ka njoftuar tërheqjen nga ekipi kombëtar për aq kohë sa Michal Probierz mbetet në postin e trajnerit. Lewandowski nuk ka marrë pjesë në ciklin e kualifikimeve në këtë muaj, duke përmendur lodhjen fizike pas një sezoni të vështirë. Ai kishte deklaruar se ky vendim ishte marrë në konsultim me trajnerin aktual. Megjithatë, tensionet mes tyre janë bërë

publike pasi Probierz ia ka hequr shiritin e kapitenit, duke ia dhënë Piotr Zielinskit, veprim që duket se ka ndikuar në vendimin përfundimtar të sulmuesit të Barcelonës. Në një njoftim të publikuar, Lewandowski ka deklaruar se në të ardhmen do të rikthehet të luajë për ekipin kombëtar të Polonisë. "Duke pasur parasysh rrethanat dhe humbjen e besimit, kam vendosur të mos luaj më për Kombëtaren për sa kohë që ky trajner është në detyrë.

Shpresoj që një ditë të mund të kthehem dhe të luaj përsëri për tifozët më të mirë në botë", ka thënë Lewandowski, i cili mban rekordet si golashënuesi dhe lojtari me më shumë paraqitje në historinë e Kombëtares së Polonisë, ndaj largimi i tij përbën një goditje të madhe për ekipin. Edhe pse në moshën 35-vjeçare, Lewandowski mbetet një figurë kyçe si në aspektin sportiv, po ashtu edhe atë motivues për skuadrën dhe tifozët.





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “A&M Automobile” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812111962 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “A&M Automobile” D.O.O. Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812111962 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “A&M Automobile” L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 812111962 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejepuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

“Istanbul Baklava” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 811937955, Gjilan me pronar Avni Kamberi dhe Kasim Ivgen bënë shpallje në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 350.000 Euro në 170.000.

- Rita Lakna shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Sami Frashëri” Prishtinë.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Vedat Gajraku shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m. Prizren “11 Marsi”.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Antigona Abrashi shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Elvana Zherka shpall të pavlefshme diplomën e shme “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sal-lon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

